



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

**RAPORT**  
*(Përfundimtar)*

**PËR**

**INSPEKTIMIN NË LIDHJE ME PROCESIN E RISTRUKTURIMIT  
DHE DISA ASPEKTE TË TJERA TË MENAXHIMIT TË  
SHËRBIMIT CIVIL**

**KËSHILLI I QARKUT DIBËR**

**Tiranë, Tetor 2015**

## RAPORT

### **Për kryerjen e inspektimit në lidhje me procesin e ristrukturimit të institucionit, Këshilli i Qarkut Dibër.**

#### **Hyrje**

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështjete të nenit 11, pika 1, si dhe të nenit 14, pikat 1 e 2 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe në zbatim të planit vjetor të inspektimit, miratuar me vendimin nr.19, datë 11.03.2015, me Vendimin nr.479/2, datë 02.07.2015, “Për kryerjen e inspektimit në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil si dhe në lidhje me procesin e ristrukturimit të institucionit, Këshilli i Qarkut Dibër, vendosi kryerjen e inspektimit të përgjithshëm në këtë institucion për verifikimin e gjendjes së ligjshmërisë në gjithë institutet e ligjit, duke nisur nga kuptimi dhe zbatimi i drejtë i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; plotësimi i kushteve ligjore të statusit të punësimit, të parashikuara në nenin 67 të ligjit të sipërcituar; lëvizja, transferimi apo lirimi nga shërbimi civil i punonjësve, nëse këto procedura janë bërë sipas parashikimeve të nenit 50, të ligjit 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin 178/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, si dhe Vendimin nr.171, datë 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil” të Këshillit të Ministrave, Kreu III “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”; përputhjen e përshkrimeve të reja të punës me modelin e parashikuar nga ligji; plotësimin e kërkesave të përgjithshme e të veçanta të pozicioneve të punës nga punonjësit e mbajtur pas ristrukturimit, etj.

Në zbatim të Vendimit nr. 479/2, datë 02.07.2015, “Për kryerjen e inspektimit në lidhje me procesin e ristrukturimit të institucionit, Këshilli i Qarkut Dibër”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, u ngrit grupi i inspektimit i përbërë nga Ledina Zhupa dhe Ilirjan Osmanlliu, të cilët në datën 09.07.2015 kanë kontaktuar personalisht me personin e kontaktit, \*\*\*\*\* me detyrë Drejtor Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, si dhe me Kryetarin e Këshillit të Qarkut Dibër, \*\*\*\*\* . Nga ana e personit të kontaktit u vu në dispozicion dokumentacioni i kërkuar, i cili u administrua, u nxorën të dhënat e nevojshme dhe u përgatit materiali në vijim duke u bazuar në objektin dhe qëllimin e inspektimit.

Procesi i inspektimit të përgjithshëm u krye gjatë muajit Korrik 2015.

#### **Qëllimi i inspektimit:**

Qëllimi i realizimit të inspektimit është:

- Monitorimi, kontrolli dhe vlerësimi i zbatimit të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin 178/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin civil” si dhe Vendimin nr.171, datë 26.03.2014, “Për

*transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil” të Këshillit të Ministrave, Kreu III “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”,*

- Paraqitja para përgjegjësve për administrimin e shërbimit civil, njësisë së burimeve njerëzore dhe titullarit të institucionit, e konstatimeve dhe fakteve të evidentuara e të vlerësuara si parregullsi në lidhje me zbatimin e ligjit për nëpunësin civil;
- Paralajmërimin e institucionit dhe personave përgjegjës, në rast të konstatimit të parregullsive gjatë zbatimit të ligjit, duke lënë detyrat dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e situatës, brenda një afati të arsyeshëm, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

### **Objekti i inspektimit**

1. Si janë kuptuar e zbatuar dispozitat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” dhe aktet nënligjore dalë në bazë e për zbatim të tij, në lidhje me procesin e ristrukturimit (*neni 50 i ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin 178/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” si dhe Vendimin nr.171, datë 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil” të Këshillit të Ministrave, Kreu III “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”*).

2. Kontrolli i procesit të ristrukturimit (zbatimi i kërkesave të nenit 50 e vijues të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij) të institucionit, Këshilli i Qarkut Dibër, në lidhje me mënyrën e zbatimit të kërkesave të ligjit në fjalë, që nga krijimi i komisionit të ristrukturimit, i cili shqyrton mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në pozicionet e lira ekzistuese, në rastin kur nëpunësi plotëson kërkesat e posaçme e deri në daljen e vendimit përfundimtar të transferimit, i cili është kompetencë e njësisë së personelit.

3. Rregullimin e ligjshmërisë në procesin e ristrukturimit nëse vërehen shkelje të procedurës dhe kushteve të përcaktuara në nenin 50 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr.178/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” si dhe Vendimin nr.171, datë 26.03.2014 “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil” të Këshillit të Ministrave, Kreu III “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”.

4. Plotësimi i kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në lidhje me statusin e punonjësve dhe nëpunësve aktualë, që do të verifikohet në këto aspekte:

- Përfshirja e funksionit në shërbimin civil në përputhje me përshkrimin e punës dhe detyrat që realizon ky funksion.
- Punonjësit ekzistues që janë punësuar në pozicione të shërbimit civil sipas këtij ligji, që janë rekrutuar sipas një procedure pranimit konkurruese, nëpërmjet procedurave të

ngjashme me dispozitat e ligjit të mëparshëm, nr. 8549, dt.11.11.1999, “*Statusi nëpunësit civil*” apo për një periudhë më të vogël se 1 (një) vit;

- Nëpunës ekzistues që janë të punësuar në pozicione, pjesë e shërbimit civil, sipas këtij ligji, pa kaluar më parë në procedurë formale konkurruese ose që kanë më pak se 1 (një) vit në këto pozicione pune;
- Rastet e refuzimit të deklarimit të statusit të nëpunësit civil;
- Si është dokumentuar procedura e ndjekur nga njësia përgjegjëse, në rastin e deklarimit të statusit të punësimit të punonjësve.

### **Metodologjia e inspektimit**

Inspektimi ka përfshirë verifikimin e procesit të ristrukturimit të Këshillit të Qarkut Dibër, praktikën e lirimimit nga shërbimi civil të nëpunësve që iu është shkurtuar pozicioni i punës apo iu janë ndryshuar kërkesat e posaçme dhe të përgjithshme, për shkak të ristrukturimit të institucionit, bazuar në Vendimin nr.3, datë 30.01.2015 “*Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të administratës së Këshillit të Qarkut Dibër për vitin 2015*”.

Me shkresën Nr. 479, datë 02.07.2015, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, njoftoi institucionin, Këshilli i Qarkut Dibër, në lidhje me fillimin e inspektimit dhe objektin e tij.

Në zbatim të programit dhe drejtimit të inspektimit të përcaktuar në Vendimin nr. 479/2, datë 02.07.2015 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, u verifikua dhe u trajtua dokumentacioni i mëposhtëm në raport me procedurat ligjore:

- Vendimi nr.3, datë 14.02.2014, i Këshillit të Qarkut Dibër, “*Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të administratës së Këshillit të Qarkut Dibër*”.
- Vendimi nr.3, datë 30.01.2015, i Këshillit të Qarkut Dibër, “*Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të Administratës së Këshillit të Qarkut Dibër*”.
- U shqyrtuan aktet e deklarimit të statusit për të gjithë nëpunësit e Këshillit të Qarkut Dibër, të lëshuara nga Njësia e Personelit.
- Formularët e përshkrimit të punës për të gjithë pozicionet e shërbimit civil sipas strukturës aktuale të vitit 2015.
- Dokumentacioni i zhvillimit të konkurrenive.
- Aktet e emërimit pas përfundimit të procesit të ristrukturimit.
- Aktet e lirimimit nga shërbimi civil të ish nëpunësve civilë të Këshillit të Qarkut Dibër, për shkak të ristrukturimit.
- Urdhri nr.25, datë 05.05.2014, i Kryetarit të Këshillit të Qarkut Dibër, “*Për krijimin e Njesisë Përgjegjëse në Këshillin e Qarkut Dibër*”.
- Urdhër nr.5, datë 02.02.2015, i Kryetarit të Këshillit të Qarkut Dibër, “*Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit në Këshillin e Qarkut Dibër*”.

## **Përmbajtja e raportit:**

**I. Procesi i deklarimit të statusit të punësimit dhe plotësimi i kushteve ligjore për të deklaruar statusin e punësimit, në përputhje me kërkesat e nenit 67 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.**

**1. Situata e administrimit të burimeve njerëzore në momentin e inspektimit.**

Ligji nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, vendos rregulla të qarta për mënyrën e administrimit të shërbimit civil, për të gjitha institucionet që hyjnë në fushën e veprimtimit të tij.

Në nenin 2 të këtij ligji, përcaktohet se ky ligj zbatohet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore, por njëkohësisht evidentohen dhe rastet përjashtimore për disa funksione të identifikuara shprehimisht në këtë dispozitë të ligjit.

Këshilli i Qarkut është krijuar dhe funksionon si organ përfaqësues i Qarkut Dibër, mbi bazën e ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ndryshuar me ligjin nr. 9208, datë 18.03.2004, i cili në nenet 5 dhe 6 të tij, e përcakton atë si njësi të qeverisjes vendore që përfshihet në fushën e shërbimit civil.

Administrata e Këshillit të Qarkut funksionon mbi bazën e strukturës organizative të miratuar nga Këshilli i Qarkut, sipas parashikimeve të nenit 54 të ligjit 8652, datë 31.07.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, në të cilin përcaktohen detyrat dhe kompetencat e Këshillit të Qarkut.

Aktualisht, subjekti i inspektimit funksionon sipas strukturës organizative të miratuar me Vendimin nr. 3, datë 30.01.2015, “Për miratimin e strukturës organizative dhe nivelit të pagave të administratës së Këshillit të Qarkut Dibër”, ndërsa në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, datë 26.02.2014, Këshilli i Qarkut Dibër ka funksionuar sipas strukturës organizative të miratuar me Vendimin nr. 03, datë 14.02.2014, “Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të Administratës së Këshillit të Qarkut Dibër”.

Struktura organizative, nr.03, datë 14.02.2014, e administratës së Këshillit të Qarkut Dibër në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit 152/2013, “Për nëpunësin civil”, datë 26.02.2014.

Sipas strukturës organizative të miratuar me Vendimin nr.03, datë 14.02.2014, “Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të Administratës së Këshillit të Qarkut Dibër”, administrata e Këshillit të Qarkut Dibër kishte gjithsej **65** pozicione pune. Duke patur parasysh klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil, sipas përcaktimeve të nenit 19 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimit nr.142, datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e

*administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, të Këshillit të Ministrave, rezulton se në këtë institucion ishin **49** pozicione pune pjesë e shërbimit civil, të cilat ndahen në këto kategori:

- Nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues janë **6** (*gjashtë*) pozicione pune, të cilat i përkasin pozicionit “*Drejtor Drejtorie*”, kategoria II-b;
- Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues janë **2** (*dy*) pozicione pune, të cilat i përkasin pozicionit “*Kryeinspektor*”, kategoria III-a/1;
- Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive janë **41** (*dyzetnjë*) pozicione pune që i përkasin pozicionit “*specialist*”, kategoria III-b dhe IV-a

**2.** *Si është kuptuar dhe zbatuar neni 67 i ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.*

Nisur nga fakti që Këshilli i Qarkut Dibër është pjesë e shërbimit civil, deklarimi si nëpunës civilë ekzistues për çdo punonjës të këtij institucioni duhet të bëhet në respektim të kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, neni 67, pikat 3, 4 dhe 6, ku përcaktohet në mënyrë të shprehur se:

- *pika 3, “Nëpunësit civilë ekzistues, punonjësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione të shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që janë rekrutuar sipas një procedure pranimi konkurruese, të ngjashme me atë të përcaktuar nga ligji nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi nëpunësit civil”, apo që janë të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë jo më të vogël se 1 vit, janë, për shkak të ligjit, nëpunës civilë”;*
- *pika 4, “Nëpunësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione pune, pjesë e shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që nuk plotësojnë kushtet e parashikuara në pikën 3 të këtij neni, janë nëpunës civilë në periudhë prove dhe për ta zbatohen dispozitat e nenit 24 të këtij ligji. Periudha e provës fillon nga fillimi i shtrirjes së efekteve të këtij ligji”;*
- *pika 6, “Deklarimi i statusit të punësimit, sipas pikave 1, 3 dhe 4 të këtij neni, bëhet nga njësia përgjegjëse pas verifikimit të procedurës së punësimit”.*

Po kështu, në Vendimin nr. 116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave, “*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, Kreu II “Statusi i nëpunësve të tjerë civilë në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura, bashkitë dhe qarqet*”, pika 1, është përcaktuar se: “*Nëpunës civilë*”, sipas pikës 3 të nenit 67, janë të gjithë ata nëpunës që kryejnë funksione të shërbimit civil në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013 dhe që janë rekrutuar sipas procedurave konkurruese, përcaktuar nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 “*Statusi i nëpunësit civil*”.

Këto janë dispozitat bazë që duhet të mbante parasysh njësia përgjegjëse për të realizuar drejt detyrimin ligjor të deklarimit të statusit të punësimit.

Për të arritur në një konkluzion të saktë lidhur me veprimet e kryera nga njësia e burimeve njerëzore, si njësia përgjegjëse për administrimin e shërbimit civil, nëse veprimet e saj janë kryer në përputhje me kërkesat e ligjit, grupi i inspektimit verifikoi dhe analizoi materialet

shkresore që përmbajnë të dhëna lidhur me pozicionet pjesë e shërbimit civil, si organigramën dhe strukturën e institucionit që ka qenë në fuqi në momentin e shtrirjes së efekteve të ligjit, Vendimin nr.03, datë 24.02.2014, “Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të Administratës së Këshillit të Qarkut Dibër”.

Në përfundim të kësaj analize, statusin e punësimit të punonjësve të këtij institucioni sipas strukturës që ka qenë në fuqi në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, **datë 26.02.2014**, mund ta kategorizojmë në këtë mënyrë:

**a.** Nëpunës, të cilët janë rekrutuar sipas procedurave konkurruese, përcaktuar në ligjin nr. 8549/1999, “Statusi i nëpunësit civil”.

Nga analiza e dokumentacionit të administruar, rezulton se nga të gjithë punonjësit e punësuar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, **4** (katër) punonjës janë punësuar në respektim të kërkesave të nenit 13 e vijues të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”, me procedura konkurimi.

Nga këqyrja e akteve të administruara dhe përmbajtja e tyre rezulton se janë respektuar procedurat ligjore të kërkuara nga ky ligj. Kështu, është shpallur pozicioni i lirë, është krijuar komiteti *ad-hoc*, ka dalë akti i përzgjedhjes dhe i emërimit, si dhe akti i konfirmimit si nëpunës civilë për **4** (katër) punonjësit, sipas përcaktimeve të nenit 13 dhe 14 të ligjit nr.8549/1999, “Statusi nëpunësit civil”.

**b.** Pozicione pune pjesë e shërbimit civil, të plotësuara me akte të përkohshme emërimi para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Nga analiza e materialeve të verifikuara, rezulton se **37** (tridhjeteshtatë) pozicione pune, pjesë e shërbimit civil në këtë institucion janë plotësuar me akt emërimi të përkohshëm sipas dispozitave të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, duke mos respektuar procedurat e parashikuara në nenin 13 të ligjit nr.8549/1999, “Statusi nëpunësit civil”, para hyrjes në fuqi të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

**c.** Pozicione pune pjesë e shërbimit civil, të plotësuara me akte të përkohshme emërimi, jo sipas përcaktimeve të nenit 22 e vijues të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” të ndryshuar, pas hyrjes në fuqi të ligjit të mësipërm, datë 26.02.2014.

Janë konstatuar **8** (tetë) pozicione pune të plotësuara me akte emërimi të përkohshëm në kundërshtim me nenin 22 e vijues të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe Vendimin nr.143, datë 12.03.2014, “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët e të mesme drejtuese”, të Këshillit të Ministrave, konkretisht:

- Specialist për marrëdhëniet me institucionet në sektorin juridik në varësi të Drejtorisë Juridike dhe të Financës.

- Specialist për prokurimet në sektorin juridik në varësi të Drejtorisë Juridike dhe të Financës.
- Specialist i projekteve dhe infrastrukturës në sektorin e projekteve në varësi të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit.
- Specialist për investimet në varësi të Drejtorisë së Shërbimeve Rajonale.
- Specialist për infrastrukturën në varësi të Drejtorisë së Shërbimeve Rajonale.
- Specialist për shërbimet sociale në varësi të Drejtorisë së Shërbimeve Rajonale.
- Specialist për mjedisin në varësi të Drejtorisë së Shërbimeve Rajonale.
- Specialist auditi.

**Konkluzion:** Pozicionet e mësipërme të punës të plotësuara në kundërshtim me përcaktimet e nenit 22 e vijues të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe Vendimit nr.143, datë 12.03.2014, “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët e të mesme drejtuese”, të Këshillit të Ministrave, me anë të njoftimit nr.469.Prot, datë 25.07.2014, janë shpallur të lira dhe plotësimi i tyre është bërë sipas përcaktimeve ligjore. Më hollësisht për zhvillimin e procedurës së konkurimit për këto pozicione pune do të flasim në kapitullin e mëposhtëm.

- *Procedura ligjore e konkurimit e ndjekur për plotësimin e pozicioneve të punës “specialist” në administratën e Këshillit të Qarkut Dibër.*

Në strukturën organizative të Këshillit të Qarkut Dibër, të miratuar me vendimin nr.03, datë 14.02.2014, të titullarit të institucionit, **8** (tetë) pozicione pune të cilat rezultojnë të paplotësuara, janë plotësuar në kundërshtim me përcaktimet ligjore të nenit 22 e vijues të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe Vendimit nr.143, datë 12.03.2014, “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët e të mesme drejtuese”, të Këshillit të Ministrave (këto pozicione janë cituar në paragrafin e mësipërm ku flitet për emërimet të përkohshme në kundërshtim me përcaktimet ligjore). Njësia përgjegjëse e Këshillit të Qarkut Dibër, e cila është krijuar me Urdhërin nr.25, datë 05.05.2014 të titullarit të institucionit, ka shpallur të lira **8** (tetë) pozicionet e punës të cilat ishin plotësuar me akte emërimi të përkohshme në kundërshtim me procedurat ligjore. Me aktin administrativ nr.469, datë 25.07.2014, bazuar në nenet 22 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe Vendimin nr. 143, datë 12.03.2014, “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”, të Këshillit të Ministrave, Kreu IV “Konkurimi”, Këshilli i Qarkut Dibër, ka shpallur procedure për pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive për grupin e pozicioneve të posaçëm “specialist”, e konkretisht,

- Specialist për marrëdhëniet me institucionet në sektorin juridik në varësi të Drejtorisë Juridike dhe të Financës.



- Specialist për prokurimet në sektorin juridik në varësi të Drejtorisë Juridike dhe të Financës.
- Specialist i projekteve dhe infrastrukturës në sektorin e projekteve në varësi të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit.
- Specialist për investimet në varësi të Drejtorisë së Shërbimeve Rajonale.
- Specialist për infrastrukturën në varësi të Drejtorisë së Shërbimeve Rajonale.
- Specialist për shërbimet sociale në varësi të Drejtorisë së Shërbimeve Rajonale.
- Specialist për mjedisin në varësi të Drejtorisë së Shërbimeve Rajonale.
- Specialist auditi.

Në njoftimin për shpalljen e procedurës së pranimit në shërbimin civil janë përcaktuar kërkesat e përgjithshme dhe të posaçme për pozicionin e punës, afati i paraqitjes së dokumentacionit dhe është bërë e ditur se si do të procedohet për të dyja fazat e konkurimit, si në lidhje me fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista, mënyra e vlerësimit të kandidatëve deri në datën e daljes së rezultateve të konkurimit. Sipas përcaktimeve të pikës 4 të nenit 22 të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, njësia përgjegjëse pas verifikimit të dokumentacionit ka bërë vlerësimin paraprak të konkurentëve, fakt i cili pasqyrohet në procesverbalin e datës 01.09.2014. Pas kësaj faze, nga ana e Komitetit të Përhershëm të Pranimit është përgatitur formulari i vlerësimit të dokumenteve për rekrutim; formulari i vlerësimit të testimit me shkrim; formulari i vlerësimit të testimit me gojë dhe në datë 15.10.2014, është bërë vlerësimi për secilin kandidat, procesverbal i cili i është vënë në dispozicion Njësisë Përgjegjëse pranë Këshillit të Qarkut Dibër. Komiteti i Përhershëm i Pranimit me anë të Vendimit nr.01, datë 15.10.2014, bazuar në kompetencat e parashikuara në pikën 5 të nenit 22 të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar dhe pikës 18 të Vendimit nr.143, datë 12.03.2014, *“Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”*, të Këshillit të Ministrave, Kreu IV, *“Konkurimi”*, ka bërë listimin e fituesve në konkurimin për pranimin në shërbimin civil dhe ia ka njoftuar këtë vendim si konkurentëve dhe njësisë përgjegjëse. Kjo e fundit ka nxjerrë aktet e emërimit për secilin kandidat fitues dhe lista e fituesve me anë të Vendimit nr.01, datë 15.10.2014 është shpallur në stendat e informimit të publikut, sipas përcaktimeve të pikës 17 të Vendimit nr.143, datë 12.03.2014, *“Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”*, të Këshillit të Ministrave, Kreu IV, *“Konkurimi”*.

**Konkluzion:** Nisur nga gjithë sa më sipër, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil vlerëson se, procedura e konkurimit është kryer në përputhje me nenet 22 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, si dhe Vendimin nr. 143, datë 12.03.2014, *“Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”*, të Këshillit të Ministrave, Kreu IV, *“Konkurimi”*. Konsiderohet si parregullsi që nuk ndikon në procesin e konkurrimit fakti që, kandidatit fitues nuk i është marrë miratimi zyrtar, përpara se njësia përgjegjëse të nxjerrë aktin e emërimit sipas

përcaktimeve të pikës 22, të Vendimit nr. 143, datë 12.03.2014, “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”, të Këshillit të Ministrave, Kreu IV, “Konkurimi”.

**dh.** Aktet e certifikimit të statusit sipas përcaktimeve të pikës 3;4 dhe 6 të ligjit nr.152/2013, ”Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Duke u nisur nga përmbajtja e pikës 3 dhe 4 të nenit 67 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe nga këqyrja e akteve, rezulton se:

- Në **29** raste nëpunësit civilë, kanë një periudhë më tepër se një vit në atë pozicion pune. Nisur nga kjo, Drejtoria e Burimeve Njerëzore sipas përcaktimeve të nenit 67 pika 3 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit si nëpunës civilë për të gjitha këto raste.

Punonjësit që kanë përfituar statusin e nëpunësit civil:

\*\*\*\*\* Inspektor Auditit;  
\*\*\*\*\* Inspektor personeli në DMBNJ;  
\*\*\*\*\* Specialiste juriste në DMBNJ ;  
\*\*\*\*\* Drejtor i Drejtorisë së Financës;  
\*\*\*\*\* Specialist finance në DF;  
\*\*\*\*\* Drejtor në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit;  
\*\*\*\*\* Specialist i pyjeve dhe mjedisit në DPZH;  
\*\*\*\*\* Specialist i bujqësisë në DPZH;  
\*\*\*\*\* Specialist i turizmit në DPZH;  
\*\*\*\*\* Specialist i arsimit dhe kulturës në DPZH;  
\*\*\*\*\* Specialist i infrastrukturës në DPZH;  
\*\*\*\*\* Specialiste e projekteve sociale në DPZH;  
\*\*\*\*\* Specialiste e projekteve sociale në DPZH ;  
\*\*\*\*\* Specialiste e statistikës në DPZH;  
\*\*\*\*\* Specialiste e teknologjisë së informacionit në DPZH;  
\*\*\*\*\* Specialist ndërtimi në Drejtorinë e Urbanistikës;  
\*\*\*\*\* Specialist hidroteknik në DU;  
\*\*\*\*\* Kryeinspektor në DU;  
\*\*\*\*\* Inspektor në DU;  
\*\*\*\*\* Inspektor në DU;  
\*\*\*\*\* Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve;  
\*\*\*\*\* Specialist për Emergjencat në DSH;  
\*\*\*\*\* Specialist për ujsjellësin në DSH;  
\*\*\*\*\* Kryeinspektore i Inspektoriatit të Mbrojtjes së Tokës;  
\*\*\*\*\* Inspektor-specialist në IMT;  
\*\*\*\*\* Drejtor i DAMT-së;  
\*\*\*\*\* Inspektor-specialist në DAMT;

\*\*\*\*\* Përgjegjës i ZAMT Burrel;  
\*\*\*\*\* Përgjegjës i ZAMT Bulqizë.

Nga përmbajtja e akteve të emërimit, ku përfshihet momenti i fillimit të marrëdhënieve të punës dhe atyre financiare, rezulton se këta punonjës kanë më shumë se një vit që e kryejnë detyrën e tyre funksionale në pozicionet në të cilat janë deklaruar si nëpunës civilë.

- Në 7 raste, nëpunësit ekzistues, janë punësuar në pozicione pjesë të shërbimit civil, por nuk plotësojnë kushtet e parashikuara në nenit 67, pika 3, të nr. ligjit 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, sepse kanë një periudhë më pak se një vit në atë pozicion pune. Drejtoria e Burimeve Njerëzore, sipas përcaktimeve të nenit 67, pika 4, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit si “nëpunës civil në periudhë prove”, për këto raste.

Punonjësit që kanë përfituar statusin e nëpunësit civil në periudhë prove në këtë kategori janë:

\*\*\*\*\* Drejtor në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore;  
\*\*\*\*\* Specialist në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore;  
\*\*\*\*\* Specialist për asistencën e komunave në DMBNJ;  
\*\*\*\*\* Specialiste për projektet e biznesit në DPZH;  
\*\*\*\*\* Drejtor i Drejtorisë së Urbanistikës;  
\*\*\*\*\* Specialist mjedisi në DU;  
\*\*\*\*\* Specialist në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës.

Nga përmbajtja e akteve të emërimit, ku përfshihet momenti i fillimit të marrëdhënieve të punës dhe atyre financiare, rezulton se këta punonjës kanë më pak se një vit që e kryejnë detyrën e tyre funksionale në pozicionet në të cilat janë deklaruar si nëpunës civilë në periudhë prove.

**Konkluzion:** Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil vlerëson se, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, si njësi përgjegjëse, e ngarkuar nga ligji për të formalizuar aktin e deklarimit të statusit, ka vepruar sipas përcaktimeve të pikës 3; 4 dhe 6 të nenit 67 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe pikës 1 të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 ”Për nëpunësin civil”, Kreu II ”Statusi i nëpunësve të tjerë civilë në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura, bashkitë dhe qarqet”, kur ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit për këto raste.

Për këto arsye, vlerësohet se Drejtoria e Burimeve Njerëzore, ka vepruar në përputhje me ligjin në lidhje me deklarimin e statusit të punësimit, për këto kategori punonjësish.

- *Mosdeklarimi i statusit të punësimit të punonjësve të cilët janë në pozicione pune që përfshihen në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil, por që nuk plotësojnë kriteret e posaçme për pozicionin e punës.*

Në 5 raste, nëpunësve ekzistues që ushtrojnë funksione në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil, i është refuzuar nga ana e njësisë përgjegjëse deklarimi i statusit të punësimit për shkak të mosplotësimit të kriterëve të posaçme (*ishin me arsim të mesëm*). Njësia përgjegjëse në nxjerrjen e këtyre akteve administrative i është referuar nenit 19 të ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*” të ndryshuar dhe Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe të pavarura*”, të Këshillit të Ministrave; Lidhja 2 “*Përshkrimi i përgjithëm i punës për çdo kategori dhe klasë*”.

Konkretisht punonjësit që iu është refuzuar deklarimi i statusit të punësimit janë:

\*\*\*\*\* Specialiste finance në Drejtorinë e Financës;  
 \*\*\*\*\* Specialist në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore;  
 \*\*\*\*\* Specialist planifikues në Drejtorinë e Urbanistikës;  
 \*\*\*\*\* Specialist planifikues urban në DU;  
 \*\*\*\*\* Specialist në DAMT .

**Konkluzion** : Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil vlerëson se, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, si njësia përgjegjëse, e ngarkuar nga ligji për të formalizuar aktin e deklarimit të statusit, ka vepruar sipas përcaktimeve të nenit 19 dhe 66, germa e të ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar; Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe të pavarura*” të Këshillit të Ministrave; LIDHJA 2 “*Përshkrimi i përgjithëm i punës për çdo kategori dhe klasë*”, kur ka nxjerrë aktin për lirimin nga shërbimi civil për shkak të mosdeklarimit të statusit të punësimit për këto raste. Punonjësit e sipërcituar nuk plotësojnë kërkesën e posaçme për formimin arsimor. Të gjithë janë me arsim të mesëm, gjë e cila bie në kundërshtim me kërkesat e nenit 19 të ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar dhe Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe të pavarura*”, të Këshillit të Ministrave; Lidhja 2 “*Përshkrimi i përgjithshëm i punës për çdo kategori dhe klasë*”.

## II. Procesi i ristrukturimit i Këshillit të Qarkut Dibër

Kriteret bazë mbi të cilat është kryer vlerësimi i ligjshmërisë së procesit të ristrukturimit (*aktet e lirim të nëpunësve që u është shkurtuar pozicioni i punës dhe aktet e riemërimit të nëpunësve të mbetur pas ristrukturimit që plotësojnë kërkesat e veçanta dhe të përgjithshme për pozicionin e ri të punës sipas përshkrimeve të reja*) nga ana e njësisë përgjegjëse janë kërkesat e nenit 50 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, Vendimit nr.142, datë 12.03.2014, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e*

pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të Këshillit të Ministrave, si dhe Vendimit nr.171, dt.26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”, të Këshillit të Ministrave dhe konkretisht:

- Përshkrimet e pozicioneve të punës dhe kërkesat e përgjithshme e të veçanta të këtyre pozicioneve dhe verifikimi i përputhshmërisë së tyre me karakteristikat personale të nëpunësve që janë riemëruar aktualisht në këto pozicione.
- Nëpunësit e riemëruar pas procesit të ristrukturimit, sipas Vendimit nr.03, datë 30.01.2015, “Për miratimin e Strukturës dhe nivelit të pagave të Administratës së Qarkut Dibër”, të Këshillit të Qarkut Dibër, gëzojnë apo jo statusin e nëpunësit civil dhe a plotësojnë apo jo kërkesat e përgjithshme e të veçanta për pozicionin e ri të punës sipas përshkrimeve të reja.

Njësia përgjegjëse në relacionin e saj të datës 20.01.2015 i ka propozuar Këshillit të Qarkut për miratim projektin e strukturës dhe nivelit të pagave për punonjësit e administratës së Këshillit të Qarkut Dibër. Struktura që i është propozuar Këshillit për miratim është e reduktuar, kjo e kushtëzuar nga neni 15 i ligjit nr.160/2014, datë 27.11.2014 “Për buxhetin e vitit 2015”

1/a Struktura organizative e Këshillit të Qarkut Dibër, para procesit të ristrukturimit.

Nga verifikimi dhe ballafaqimi me ligjin i materialeve shkresore të vëna në dispozicion nga ana e personit të kontaktit gjatë vizitës në subjekt, në rrugë elektronike apo me korrespondencë zyrtare, ka rezultuar se:

Sipas strukturës së mëparshme, të miratuar me Vendimin nr. 03, datë 14.02.2014, “Për miratimin e Strukturës dhe nivelit të pagave të Administratës së Qarkut Dibër”, të Këshillit të Qarkut Dibër, numri i përgjithshëm ishte **65** punonjës, nga të cilët **49** pozicione përfshiheshin në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil dhe struktura e aparatit administrativ të institucionit kishte organizimin e mëposhtëm :

**I. Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore** , me organikë **1 Drejtor**, në përbërje të së cilës janë **2** sektorë e konkretisht:

**1-Sektori i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore**, me organikë **4 specialistë**, gjithsej **4** pozicione pune që përfshihen në shërbimin civil.

**2-Sektori i administratës**, në organikën e të cilit nuk ka pozicione pune që përfshihen në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil.

Gjithsej në DMBNJ janë **5** pozicione pune që përfshihen në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil.

**II. Drejtoria Juridike dhe e Financës**, me organikë **1 Drejtor**, në përbërje të së cilës janë **2** Sektorë e konkretisht:

**1-Sektori i financës**, me organikë **2 specialistë**, gjithsej **2** pozicione pune që përfshihen në shërbimin civil.

**2-Sektori Juridik**, me organikë **3 specialistë**, gjithsej **3** pozicione pune që përfshihen në shërbimin civil.

Gjithsej në DJF janë **6** pozicione pune që përfshihen në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil.

**III. Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Rajonit**, me organikë **1 Drejtor**, në përbërje të së cilës janë **3** sektorë e konkretisht:

**1-Sektori i Zvillimit Rajonal** me organikë **5 specialistë**, gjithsej **5** pozicione pune që përfshihen në shërbimin civil.

**2-Sektori i Monitorimit të Projekteve**, me organikë dhe **4 specialistë**, gjithsej **4** pozicione pune që përfshihen në shërbimin civil.

**3-Sektori i Teknologjisë së Informacionit**, me organikë **2 specialistë**, gjithsej **2** pozicione pune që përfshihen në shërbimin civil.

Gjithsej në DPZHR janë **12** pozicione pune që përfshihen në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil.

**IV. Drejtoria e Urbanistikës**, me organikë **1 Drejtor**, në përbërje të së cilës janë **2** sektorë e konkretisht:

**1-Sektori i Planifikimit Urban** me organikë **5 specialistë**, gjithsej **5** pozicione pune që përfshihen në shërbimin civil.

**2-Sektori i Inspektoriatit të Ndërtimit** me organikë **1 Kryeinspektor** dhe **2 inspektore specialistë**, gjithsej **3** pozicione pune që përfshihen në shërbimin civil.

Gjithsej në DU janë **9** pozicione pune që përfshihen në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil.

**V. Drejtoria e Shërbimeve Rajonale**, me organikë **1 Drejtor**, në përbërje të së cilës janë **2** sektorë e konkretisht:

**1-Sektori i Shërbimeve** me organikë **5 specialistë**; gjithsej **5** pozicione pune që përfshihen në shërbimin civil.

**2-Sektori i Ujësjellësit** me organikë **1 specialist**; gjithsej **1** pozicion pune që përfshihet në shërbimin civil.

Gjithsej në DU janë **7** pozicione pune, që përfshihen në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil.

**VI. Inspektoriat i Mbrojtjes së Tokës**, me organikë **1 Kryeinspektor** dhe **2 inspektorë**.

Gjithsej në IMT janë **3** pozicione pune që përfshihen në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil.

**VII. Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Qark** (*funksion i deleguar*), me organikë **1 Drejtor**, **2 përgjegjës** dhe **2 specialistë**, gjithsej **5** pozicione pune që përfshihen në shërbimin civil.

**VIII. Sektori i Auditit**, me organikë **2 specialistë auditi**, gjithsej **2** pozicione pune që përfshihen në shërbimin civil.

Sa më sipër rezulton se numri i përgjithshëm i nëpunësve civilë është **49** (*dyzetënëntë*), nga të cilët:

- **6** (*gjashtë*) Drejtor Drejtorie (*nëpunës civil i kategorisë së mesme drejtuese*) ;
- **2** (*dy*) Kryeinspektorë (*nëpunës civil i nivelit të ulët drejtues*);
- **41** (*dyzetënjë*) specialistë (*nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive*).

1/b *Struktura organizative e Këshillit të Qarkut Dibër pas procesit të ristrukturimit, miratuar me Vendimin nr.03, datë 30.01.2015, të Këshillit të Qarkut Dibër.*

Sipas Vendimit nr.03, datë 30.01.2015, “*Mbi strukturën organizative të Këshillit të Qarkut Dibër*”, që është në fuqi në momentin e inspektimit të përgjithshëm, rezulton që administrata e Këshillit të Qarkut Dibër ka gjithsej **30** pozicione pune, nga të cilët **20** pozicione pune në shërbimin civil. Struktura është e organizuar si më poshtë:

**I. Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore**, me organikë **1** (një) **Drejtor** dhe në varësi administrative të së cilës janë **6** sektorë dhe **1** Inspektoriat, konkretisht;

- 1. Sektori i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore**, me organikë **2** (dy) **specialistë**, gjithsej **2** nëpunës civilë;
- 2. Sektori Mbështetës**, në organikë ne e të cilit nuk ka pozicione pune që përfshihen në fushën e veprimtimit të ligjit për shërbimin civil;
- 3. Sektori Ekonomik**, me organikë **1**(një) **përgjegjës sektori** dhe **2** (dy) **specialistë**, gjithsej **3** nëpunës civilë;
- 4. Sektori Shërbimeve**, me organikë **1**(një) **përgjegjës sektori** dhe **1** (një) **specialistë**, gjithsej **2** nëpunës civilë;
- 5. Sektori Planifikimit Urban**, me organikë **1**(një) **përgjegjës sektori** dhe **1** (një) **specialistë**, gjithsej **2** nëpunës civilë;
- 6. Sektori Projekteve Rajonale**, me organikë **1**(një) **përgjegjës sektori** dhe **1** (një) **specialistë**, gjithsej **2** nëpunës civilë;
- 7. Inspektoriat i Mbrojtjes së Tokës**, me organikë **1** (një) **Kryeinspektor** dhe **1**(një) **specialist**, gjithsej **2** nëpunës civilë;
- 8. Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës në Qarkun Dibër** (funksion i deleguar), me organikë **1**(një) **Drejtor**, **2**(dy) **përgjegjës zyre**, **2**(dy) **specialistë**, gjithsej **5** (pesë) nëpunës civilë.

Dhe **1**(një) **specialist audit**, nëpunës civil i kategorisë ekzekutive .

Sa më sipër rezulton se, me miratimin e strukturës së re me Vendimin nr. 03, datë 30.01.2015, “*Mbi strukturën organizative dhe nivelin e pagave të administratës të*

Këshillit të Qarkut Dibër”, në këtë institucion, janë **20** (njëzet) **pozicione pune**, nga të cilët:

- **2** (dy) **Drejtor Drejtorie**, (nëpunës civil i nivelit të mesëm drejtues);
- **5** (pesë) **përgjegjës sektori** (nëpunës civil i nivelit të ulët drejtues);
- **13** (trembëdhjetë) **specialistë**, (nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive);

Nga krahasimi i strukturave, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil konstaton se institucioni, Këshilli i Qarkut Dibër ka kaluar një proces ristrukturimi (*konstatohet plotësimi i dy kërkesvet ligjore për të pasur një proces ristrukturimi: shkurtimi i numrit të përgjithshëm të nëpunësve civilë dhe ndryshimi i strukturës organizative*). Në strukturën aktuale nuk ekzistojnë si njësi organizative **4** (katër) **Drejtori** dhe është shkurtuar numri i përgjithshëm i nëpunësve civilë nga **49** (dyzetëntë) që ishin me strukturën e mëparshme, me strukturën aktuale janë efektive vetëm **20** (njëzet) nëpunës.

- *Gjendja e respektimit të kërkesave ligjore për përshkrimin e punës.*

Sipas parashikimeve të nenit 50 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Vendimit nr.171, datë 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”, të Këshillit të Ministrave dhe Vendimit nr.142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të Këshillit të Ministrave, është njësi përgjegjëse ajo që drejton gjithë procesin nga ana ligjore. Ajo përcakton kriteret e vendeve të reja të punës pas ristrukturimit dhe krijon komisionin e ristrukturimit, i cili shqyrton mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese. Komisioni i ristrukturimit i propozon me shkrim njësisë përgjegjëse transferimin e nëpunësit dhe e mbështet propozimin e tij mbi kriteret specifike të vendeve të lira apo të krijuara të reja si pasojë e ristrukturimit dhe të dhënat e nëpunësve civilë. Pas kësaj procedure është njësi përgjegjëse, e cila ka detyrimin ligjor për marrjen e vendimit përfundimtar për lirin nga shërbimi civil të nëpunësve që iu është shkurtuar pozicioni i punës dhe u ka ndryshuar përshkrimi i punës, pas propozimit të bërë nga komisioni i ristrukturimit.

Përshkrimet e reja të punës i kanë paraprirë procesit të ristrukturimit. Sipas pikës 14 “Procedura dhe formati i përshkrimit të punës” të Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të Këshillit të Ministrave dhe Vendimit nr.32, datë 30.01.2015, “Për disa shtesa e ndryshime në Rregulloren e Brendshme të Këshillit të Qarkut Dibër”, përshkrimet e reja të punës janë diktuar nga ndryshimi i mënyrës së organizimit të Këshillit të Qarkut Dibër, si pasojë e ristrukturimit dhe janë një përmbledhje e misionit, qëllimit të përgjithshëm, detyrave kryesore dhe përgjegjësisë kryesore të pozicionit të punës, për shkak se duhet vlerësuar pozicioni i punës në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e reja. Një numër më i reduktuar nëpunësish civilë do të plotësojnë gjithë detyrimet në funksion të arritjes së misionit për të cilin është krijuar institucioni i Këshillit të Qarkut. Pra, **20** nëpunësit e emëruar pas procesit të ristrukturimit



do të realizojnë detyrat që më parë i kanë realizuar **49** nëpunës civilë e për rrjedhojë përzgjedhja e tyre duhej bërë mbi bazën e kërkesave për një nivel më të lartë profesional, me aftësi të mira organizative dhe menaxhuese, si dhe përvojën e duhur për zgjidhjen e problemeve.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, vlerëson se, kriteret e mësipërme janë mbajtur parasysh nga komisioni i ristrukturimit dhe njësia përgjegjëse në marrjen e vendimeve përfundimtare të emërimit në pozicionet e mbetura pas procesit të ristrukturimit.

- *Respektimi i kërkesave ligjore për zbatimin e nenit 50 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar dhe Vendimit nr.171, dt.26.03.2014, "Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil", të Këshillit të Ministrave.*

Drejtuasi i njësisë organizative përgjegjëse i Këshillit të Qarkut Dibër, bazuar në Vendimin nr.142, datë 12.03.2014, "*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*", të Këshillit të Ministrave, Kreu IV "*Procedura dhe formati i përshkrimit të punës*", në funksion të procesit të ristrukturimit dhe në zbatim të Vendimit nr.03, datë 30.01.2015, "*Për miratimin e strukturës organizative të Administratës së Këshillit të Qarkut Dibër*", ka hartuar përshkrimet e punës.

Përshkrimet e reja të punës janë bërë duke riklasifikuar pozicionet e mbetura në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e reja dhe janë një përmbledhje e misionit dhe qëllimit të përgjithshëm të Këshillit të Qarkut.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, konstaton se, i gjithë procesi i ristrukturimit është kryer në përputhje me ligjin. Vendimet e lirimit dhe riemërimit të nëpunësve civilë aktualë janë hartuar në përputhje me nenin 50 të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, Vendimin nr.171, datë 26.03.2014, "*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil*", të Këshillit të Ministrave dhe Vendimin nr.142, datë 12.03.2014, "*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*", të Këshillit të Ministrave, më konkretisht:

### **III. Procedura e ndjekur nga njësia përgjegjëse e burimeve njerëzore në marrjen e vendimit përfundimtar të riemërimit në shërbimin civil të nëpunësve pas ristrukturimit të institucionit, komenti ligjor dhe konkluzionet për secilin rast.**

Komisioni i Ristrukturimit është krijuar me me Urdhrin nr.05, datë 02.02.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Dibër, "*Për krijimin e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit*", dalë në bazë e për zbatim të Vendimit nr.03, datë 30.01.2015, të Këshillit të Qarkut Dibër, "*Për miartimin e strukturës organizative të Administratës së Këshillit të Qarkut Dibër*", nenit 50 të ligjit nr.152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, Vendimit nr.171, dt.26.03.2014, "*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil*", të Këshillit

të Ministrave, Vendimit nr.142, datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të Këshillit të Ministrave dhe Udhëzimit nr.3, datë 14.04.2014, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit”, të Departamentit të Administratës Publike.

Komisioni i Ristrukturimit pasi ka përmbushur detyrimet ligjore të përcaktuara në pikën 3 të nenit 50 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Vendimin nr.171, dt. 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”, të Këshillit të Ministrave, ka bërë propozimet përkatëse para njësisë të personelit për sistemimin në punë të punonjësve më të përshtatshëm.

Për këtë është mbajtur si kriter thelbësor fakti që, gjithë kompetencat dhe funksionet e Këshillit të Qarkut (të cilat janë të pandryshuara, pasi nuk kemi ndryshime të qëllimit, funksionit apo kompetencave të institucionit) do të plotësohen me një numër më i vogël punonjësish. Kjo situatë ka diktuar shkrirjen e katër drejtorive, uljen e nivelit dhe kategorive të vendeve të punës dhe bashkimin e disa funksioneve të mëparshme në një pozicion pune.

Kjo ka sjellë si pasojë edhe konkluzionin e Komisionit të Ristrukturimit, që pas ristrukturimit, në punë do të mbaheshin punonjësit më të kualifikuar dhe më me eksperiencë (kriter ka qenë vlerësimi vjetor, vjetërsia në pozicion aktual), në mënyrë që të ishin të aftë të përshtateshin me gjendjen e re të punëve, ku një nëpunës i vetëm duhej të përballonte punën e disa funksioneve, sipas strukturës së mëparshme.

Po kështu, Komisioni i Ristrukturimit, me anë të procesverbalit të datës 03.02.2015, drejtuar njësisë përgjegjëse (Njësisë së Burimeve Njerëzore), bazuar në pikën 7 të nenit 50 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, i propozon kësaj të fundit Vendimin nr.1; datë 05.02.2015, “Për emërimin e nëpunësve civilë në pozicione të lira ekzistuese si dhe lirimin dhe sistemimin në listën e pritjes të nëpunësve si pasojë e shkurtimit të vendit të punës”;

Këto vendime janë marrë pasi Komisioni i Ristrukturimit ka shqyrtuar dokumentacionin e nevojshëm ligjor (*dosjen personale*), përshkrimet e punës së pozicioneve të ristrukturuara, kriteret specifike të vendeve të lira të krijuara, vlerësimin vjetor dhe vjetërsinë në punë të secilit nëpunës. Nisur nga gjithë sa u tha më sipër, njësia e personelit ka pranuar propozimet e Komisionit të Ristrukturimit dhe ka nxjerrë aktet e riemërimit pas ristrukturimit.

**Konkluzion:** Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, konstaton se, në rastin kur ka pasur ulje në detyrë të punonjësit pas riemërimit, nuk është marrë mendimi i tij me shkrim për pranimin ose refuzimin e pozicionit të ofruar siç përcaktohet në pikën 19 dhe 20, Kreu III, “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”, të Vendimit nr.171, datë 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”, por kjo parregullsi nuk e bën të pavlefshëm vendimin e emërimit, i cili i plotëson kërkesat e nenit 50 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Vendimit nr. 171, datë 26.03.2014, “Për

*transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”, të Këshillit të Ministrave, Kreu III “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit” dhe Vendimit nr.142, datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të Këshillit të Ministrave. Këto pëlqime me shkrim duhet të plotësohen menjëherë dhe të vendosen në dosjet përkatëse.*

- *Aktet e emërimit pas ristrukturimit të Këshillit të Qarkut Dibër, sipas Vendimit nr.03, datë 30.01.2015,” Mbi strukturën organizative dhe nivelin e pagave të Administratës të Këshillit të Qarkut Dibër”.*

1. *\*\*\*\*\**, me aktin administrativ nr.23, datë 02.05.2014, pas përfundimit të procedurës së konkurimit të zhvilluar sipas përcaktimeve të nenit 22 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 143, datë 12.03.2014, “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”, të Këshillit të Ministrave, Kreu IV “Konkurimi”, është emëruar, në detyrën e specialistit të auditit (*nëpunës civil i kategorisë ekzekutive*). Më parë nëpunësi ka ushtruar të njëjtën detyrë dhe ka pasur prioritet në përzgjedhje, sepse zotëron edhe çertifikatën e auditit. (*Fillimi i marrëdhënies së punës me aktin nr.23, datë 02.05.2014 dhe akti i deklaramit të statusit të punësimit nr.115, datë 20.10.2014*). Nëpunësi plotëson kërkesat e posaçme (*arsimi i lartë - financë-kontabilitet, mbi 5 vjet eksperiencë pune*) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës.

**Konkluzion:** Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, vlerëson se, akti i deklaramit të statusit të punësimit për nëpunësin civil *\*\*\*\*\**, në bazë të nenit 67 pikat 3 dhe 4 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duhej të evidentonte faktin që ky punonjës ishte nëpunës civil në periudhë prove. Gjithashtu, duhet mbajtur parasysh që pavarësisht se pas ristrukturimit, nëpunësit që nuk i ka ndryshuar emërtesa dhe përshkrimi i pozicionit të punës (si në rastin konkret) mbetet në të njëjtin vend pune, duhet të përsëritet emërimi sipas strukturës së re dhe jo të lihet sin ë këtë rast, me emërimin fillestar.

2. *\*\*\*\*\**, me aktin administrativ nr.07, datë 03.02.2014, është emëruar në pozicionin Drejtor i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (*nëpunës civil i nivelit të mesëm drejtues, kategoria II b*). Më parë nëpunësi ka qenë në të njëjtën detyrë (*Fillimi i marrëdhënies së punës me aktin nr.07, datë 03.02.2014 dhe akti i deklaramit të statusit të punësimit nr.75, datë 10.06.2014*). Nëpunësi plotëson kërkesat e posaçme (*arsimi i lartë, dega matematikë fizikë, mbi 25 vjet eksperiencë pune sipas librezës së punës*) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës.

Ky nëpunës ka pasur përparësi në emërim, për arsye se edhe para ristrukturimit ka ushtruar të njëjtat funksione. Edhe për këtë rast, mbetet vërejtja e mësipërme që pavarësisht se pas ristrukturimit, nëpunësi të cilit nuk i ka ndryshuar emërtesa dhe

përshkrimi i pozicionit të punës (si në rastin konkret) dhe mbetet në të njëjtin vend pune, duhet të përsëritet emërimi sipas strukturës së re dhe jo të lihet me emërimin fillestar.

3. \*\*\*\*\*, me aktin administrativ nr.06, datë 01.04.2013, është emëruar në detyrën e specialist jurist në Sektorin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (*nëpunës civil i kategorisë ekzekutive, kategoria IV-a*). Më parë nëpunësi ka kryer të njëjtën detyrë (emëruar me Vendimin nr.6, datë 01.04.2013 dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nr.74, datë 10.06.2014).

Nëpunësi \*\*\*\*\* plotëson kërkesat e posaçme (*arsimi i lartë shkenca juridike*) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës, për më tepër e ka ushtruar dhe më parë këtë detyrë. Edhe për këtë rast, mbetet vërejtja e mësipërme që pavarësisht se pas ristrukturimit, nëpunësi të cilit nuk i ka ndryshuar emërtesa dhe përshkrimi i pozicionit të punës (si në rastin konkret) dhe mbetet në të njëjtin vend pune, duhet të përsëritet emërimi sipas strukturës së re dhe jo të lihet me emërimin fillestar.

4. \*\*\*\*\*, me aktin administrativ nr.119, datë 03.11.2014, është emëruar në detyrën e specialist-jurist të arkivit në Sektorin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (*nëpunës civil i kategorisë ekzekutive, kategoria IV-a*). Para ristrukturimit nëpunësi ka ushtruar detyrën e specialistit të infrastrukturës në Drejtorinë e Planifikimit të Zhvillimit Rajonal (emëruar me aktin administrativ nr.119, datë 03.11.2014 pas përfundimit të procedurës së konkurimit në vend të nëpunësit civil Kujtim Abazi, i cili ka mbushur moshën për pension të plotë pleqërie dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nr.978/16, datë 05.06.2014, kategoria IV-a).

Sipas përcaktimeve të nenit 24 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, nëpunësi konsiderohet në periudhë prove që zgjat 1 (një) vit nga data e aktit të emërimit. Edhe për këtë rast, mbetet vërejtja që pavarësisht se pas ristrukturimit, nëpunësi të cilit nuk i ka ndryshuar emërtesa dhe përshkrimi i pozicionit të punës (si në rastin konkret) dhe mbetet në të njëjtin vend pune, duhet të përsëritet emërimi sipas strukturës së re dhe jo të lihet me emërimin e fillimit të marrëdhënies së punës.

4. \*\*\*\*\* me aktin administrativ nr.42, datë 09.02.2015, është emëruar në pozicionin përgjegjës i sektorit të financës (*nëpunës civil i nivelit të ulët drejtues, kategoria III- a/1*). Më parë nëpunësi ka qenë në detyrën e Drejtorit të Financës (Fillimi i marrëdhënies së punës me aktin nr.41, datë 08.07.2012 dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nr.47, datë 10.06.2014). Nëpunësi plotëson kërkesat e posaçme (*arsimi i lartë, dega financë, mbi 25 vjet eksperiencë pune sipas librezës së punës*) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës.

Nëpunësi në fjalë ka pasur përparësi në emërim, për arsye se më parë ka ushtruar detyrën e Drejtorit të Financës.

5. \*\*\*\*\*, me aktin administrativ nr.45, datë 09.02.2015, është emëruar në detyrën e specialistit të financës në sektorin e financës (*nëpunës civil i kategorisë ekzekutive, kategoria IV-a*). Para ristrukturimit nëpunësi ka qenë në të njëjtën detyrë, por

në Drejtorinë e Kordinimit dhe Zbatimit të Strategjive Rajonale, e cila është përfshirë në Drejtorinë e Financës, (emëruar me aktin administrativ nr.22, datë 02.05.2012 dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nr.62, datë 10.06.2014, kategoria IV-a).

Nëpunësi plotëson kërkesat e posaçme (arsimi i lartë ekonomi financë, mbi 3 vjet eksperiencë pune) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës.

6. \*\*\*\*\*, me aktin administrativ nr.10, datë 02.05.2013, është emëruar në pozicionin specialiste në sektorin e financës (nëpunës civil i kategorisë ekzekutive). Më parë nëpunësja ka qenë në të njëjtën detyrë (Fillimi i marrëdhënies së punës me aktin nr.10, datë 02.05.2013 dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit i është refuzuar). Nga ana e njësisë përgjegjëse, me të drejtë i është refuzuar deklarimi i statusit të punësimit për shkak të mosplotësimit të kriterëve të posaçme (kriteri arsimor, arsimi i mesëm). Njësia përgjegjëse në nxjerrjen e këtij akti administrativ i është referuar nenit 19 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe të pavarura”, të Këshillit të Ministrave; Lidhja 2 “Përshkrimi i përgjithëm i punës për çdo kategori dhe klasë”.

**Konkluzion:** Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil arrin në konkluzionin se, riemërimi i nëpunëses civile \*\*\*\*\* në pozicionin e specialistes së financës është bërë në kundërshtim me nenin 19 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe të pavarura”, të Këshillit të Ministrave; Lidhja 2 “Përshkrimi i përgjithëm i punës për çdo kategori dhe klasë”, sepse nëpunësja në fjalë nuk gëzon statusin e nëpunësit civil, për shkak të mosplotësimit të kriterit arsimor. Për rrjedhojë, bazuar në nenin 116/c të Kodit të Procedurës Administrative duhet të kërkohet pavlefshmëria e aktit të emërimit nr.10, datë 02.05.2015 dhe plotësimit e pozicionit ose nga lista e pritjes, ose të shpallet si i lirë.

7. \*\*\*\*\*, me aktin administrativ nr.41, datë 09.02.2015, është emëruar në pozicionin përgjegjës i sektorit të shërbimeve (nëpunës civil i nivelit të ulët drejtues, kategoria III- b). Më parë nëpunësi ka ushtruar detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve (Fillimi i marrëdhënies së punës me aktin nr.07, datë 01.04.2001 dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nr.66, datë 10.06.2014). Nëpunësi plotëson kërkesat e posaçme (arsimi i lartë, dega inxhinieri, mbi 25 vjet eksperiencë pune sipas librezës së punës) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës.

Nëpunësi në fjalë ka pasur përparësi në emërim, për arsye se më parë ka ushtruar funksionet e drejtorit të drejtorisë.

8. \*\*\*\*\*, me aktin administrativ nr.48, datë 09.02.2015, është emëruar në pozicionin specialist në sektorin e shërbimeve (nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria IV-a). Para ristrukturimit nëpunësi ka qenë në të njëjtën detyrë, por në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Rajonit (emëruar me aktin administrativ nr.14, datë 01.03.2011 dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nr.51, datë 10.06.2014, kategoria IV-b).

9. \*\*\*\*\*, me aktin administrativ nr.43, datë 09.02.2015, është emëruar në pozicionin përgjegjës i sektorit të planifikimit urban (*nëpunës civil i nivelit të ulët drejtues, kategoria III-a/1*). Para ristrukturimit nëpunësi ka qenë detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Urbanistikës, e cila nuk ekziston më në strukturën aktuale dhe funksionet dhe detyrat e kësaj drejtorie i kanë kaluar sektorit të planifikimit urban (*emëruar me aktin administrativ nr.05, datë 03.02.2014 dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nr.72, datë 10.06.2014, nëpunës civil në periudhë prove, kategoria III-b*).

10. \*\*\*\*\*, me aktin administrativ nr.47, datë 09.02.2015, është emëruar në pozicionin specialist ndërtimi në sektorit të planifikimit urban (*nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria IV-a*). Para ristrukturimit nëpunësi ka qenë në të njëjtën detyrë, por në Drejtorinë e Urbanistikës, e cila nuk ekziston më në strukturën aktuale dhe funksionet dhe detyrat e kësaj drejtorie i kanë kaluar sektorit të planifikimit (*emëruar me aktin administrativ nr.21, datë 01.03.2011 dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nr.61, datë 10.06.2014, nëpunës civil kategoria IV-a*).

Nëpunësi \*\*\*\*\* plotëson kërkesat e posaçme (*arsimi i lartë shkenca inxhinierike, mbi 5 vjet përvojë pune*) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës.

11. \*\*\*\*\*, me aktin administrativ nr.44, datë 09.02.2015, është emëruar në pozicionin përgjegjës i sektorit të projekteve rajonale (*nëpunës civil i nivelit të ulët drejtues, kategoria III b*). Para ristrukturimit nëpunësi ka qenë në detyrën e Drejtorit të Planifikimit dhe Zhvillimit Rajonal, e cila nuk ekziston më në strukturën aktuale dhe funksionet dhe detyrat e kësaj drejtorie i kanë kaluar sektorit të projekteve rajonale (*emëruar me aktin administrativ nr.02, datë 03.05.2007 dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nr.68, datë 10.06.2014, kategoria III-a/1*).

Nëpunësi \*\*\*\*\* plotëson kërkesat e posaçme (*arsimi i lartë shkenca inxhinierike, mbi 10 vjet përvojë pune*) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës. Ka pasur avantazh në emërim, sepse më parë ka ushtruar detyrën e drejtorit të drejtorisë.

12. \*\*\*\*\*, me aktin administrativ nr.46, datë 09.02.2015, është emëruar në pozicionin specialist në sektorin e projekteve rajonale, pas përfundimit të procedurës së konkurimit, bazuar në nenin 22 e vijues të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar dhe Vendimit nr.143, datë 12.03.2014, "Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët e të mesme drejtuese", të Këshillit të Ministrave (*nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria IV-b*) Para ristrukturimit nëpunësi ka qenë në detyrën e specialistit në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit Rajonal (*emëruar me aktin administrativ nr.83, datë 01.07.2014 dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nr.109, datë 20.10.2014, kategoria IV-b*).

**Konkluzion:** Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil vlerëson se, akti i deklarimit të statusit të punësimit nr.109, datë 01.07.2014 për nëpunësin civil \*\*\*\*\* ka dalë në kundërshtim me përcaktimet e pikave 3 dhe 4 të nenit 67 të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil", të ndryshuar. Sipas përcaktimeve të nenit 24 të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, nëpunësi konsiderohet në periudhë prove që zgjat 1(një) vit

nga data e aktit të emërimit, prandaj dhe akti i deklarimit të statusit, duhej të specifikonte që ishte nëpunës civil në periudhë prove dhe njësia e personelit duhej të tregonte kujdes për plotësimin e gjithë kushteve që parashikohen për këtë status.

**13.** \*\*\*\*\* , me aktin administrativ nr.37/1, datë 01.06.2001, është emëruar në pozicionin Kryeinspektore në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës (*nëpunës civil i ulët drejtues, kategoria III-b*). Para ristrukturimit nëpunësja ka ushtruar të njëjtin funksion (*emëruar me aktin administrativ nr.37/1, datë 01.06.2001 dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nr.60, datë 10.06.2014, kategoria III-b*).

Nëpunësja \*\*\*\*\* plotëson kërkesat e posaçme (*arsimi i lartë, ILB Tiranë*) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës. Sipas pikës nr.3, të Vendimit nr.01, datë 05.02.2015 ”*Për transferimin, lirim dhe sistemimin në listën e pritjes të nëpunësve si pasojë e ristrukturimit të institucionit*”, të njësise përgjegjëse, nëpunësit që nuk i ka ndryshuar emërtesa dhe pozicioni i punës nuk janë riemëruar, por si akt emërimi kanë atë të fillimit të marrëdhënies së punës.

**14. Pozicion pune i paplotësuar**, specialist në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës (*nëpunës civil i kategorisë ekzekutive, kategoria IV-a*). Inspektoriati i Mbrojtjes së Tokës ka kaluar në proces ristrukturimi, sepse ka shkurtim të pozicioneve të punës. Nga 3 nëpunës që ishin në strukturën paraardhëse, janë aktualisht dy pozicione në shërbimin civil. Duke mbajtur të paplotësuar 1(një) pozicion specialist në këtë strukturë, njësia përgjegjëse cënon të drejtën e punësimit për njërin nga dy punonjësit, që mund të jenë kandidatë potencial për tu punësuar në vendin që nuk është plotësuar akoma. Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil kërkon plotësimin e pozicionit “*specialist*”, sipas përcaktimeve të nenit 50, të ligjit 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar me ligjin 178/2014, “*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil*”, si dhe Vendimin nr.171, datë 26.03.2014, “*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil*” të Këshillit të Ministrave, Kreu III “*Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit*”, nga njëri prej dy nëpunësve civilë, të mbetur pa u sistemuar e që e kanë ushtruar edhe më parë këtë detyrë.

Në observacionin e dërguar kërkohet rishikimi i pikës 2 në rubrikën “*Konkluzione*”, me pretendimin se mosplotësimi i pozicionit të punës “*Inspektor*” në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës është për shkaqe objektive që lidhen me pamundësitë financiare të institucionit. Për rrjedhojë, kërkohet që në raportin përfundimtar të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil të lihet si alternativë edhe ndryshimi i strukturës organizative (*shkurtimi i këtij pozicioni pune*).

Kërkesa e mësipërme për lënien si alternative, ndryshimin e strukturës në të ardhmen, nuk mund të merret parasysh nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pasi, së pari, ndryshimi i strukturës organizative është kompetencë e Këshillit të Qarkut Dibrë sipas parashikimeve të nenit 54, të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000, “*Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore*” dhe ky organ e vlerëson vetë nëse duhet të bëjë ndryshime, shtesa apo shkurtime në organikë. Nga ana tjetër, sistemimi, në pozicionin e lirë të njërit prej specialistëve që kanë mbetur pa u sistemuar pas ristrukturimit, është një proces që nuk është nevoja të bëhen shpenzime financiare shtesë, pasi ata janë në listë

pritje dhe mund të kalojnë, seicili prej tyre, pa konkurim në pozicionin e lirë, me emërim direkt nga lista e pritjes.

**Konkluzion:** Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil arrin në përfundimin se, procedurat e ndjekura nga komisioni i ristrukturimit dhe njësia përgjegjëse, bazuar në kompetencat ligjore të parashikuara në nenin 50 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Vendimin nr.171, datë 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimimin nga shërbimi civil”, të Këshillit të Ministrave, Kreu III “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit” dhe Vendimin nr.142, datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” të Këshillit të Ministrave, në nxjerrjen e vendimit përfundimtar të emërimit, kanë qenë në funksion të mënyrës së re të organizimit të Këshillit të Qarkut Dibër si pasojë e ristrukturimit, realizimit të misionit, qëllimit të përgjithshëm, detyrave dhe përgjegjësisve kryesore. Për këtë arsye, është vendosur që nëpunësit që janë mbajtur dhe riuemëruar të kenë një nivel të lartë profesional, të kenë aftësi organizative, menaxhuuese, të kenë përvojë në zgjidhjen e problemeve (është konkluduar nga komisioni i ristrukturimit dhe njësia përgjegjëse që ish drejtorët të drejtojnë në funksionin e përgjegjës të sektorit dhe të gjithë specialistët e riuemëruar pas ristrukturimit të kryejnë të njëjtin funksion, ose funksione të përafërta që kanë kryer dhe më parë).

Riuemërimet e nëpunësve civilë në pozicione të një kategorie të barabartë ose më të ulët janë bërë pa marrë paraprakisht deklarimin me shkrim të nëpunësit nëse pranon ose jo detyrën e re, siç përcaktohet në pikën 20, Kreu III “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”, të Vendimit nr.171, datë 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimimin nga shërbimi civil” .

#### **Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Qarkun Dibër** **(Funksion i Deleguar)**

15. \*\*\*\*\* është riuemëruar Drejtor i Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Qarkun Dibër (Fillimi i marrëdhënies së punës me aktin nr.16, datë 01.04.2006 dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nr.65, datë 10.06.2014).

16. \*\*\*\*\* është riuemëruar inspektor-specialist i Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (Fillimi i marrëdhënies së punës me aktin nr.07, datë 18.01.2006 dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nr.59, datë 10.06.2014).

17. \*\*\*\*\* është riuemëruar inspektor-specialist i Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (Fillimi i marrëdhënies së punës me aktin nr.45, datë 01.10.2010).

18. \*\*\*\*\* është riuemëruar përgjegjës Zyrës së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës Burrel (Fillimi i marrëdhënies së punës me aktin nr.23/3, datë 16.06.2003 dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nr.58, datë 10.06.2014).



19. \*\*\*\*\* është riemëruar përgjegjëse e Zyrës së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës Bulqizë (*Fillimi i marrëdhënies së punës datë 01.06.2001 dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nr.56, datë 10.06.2014*).

**Konkluzion:** Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil konstaton se, për të gjithë nëpunësit civilë të Drejtorisë së Administrimit të Tokës në Qarkun Dibër (*funksion i deleguar*), njësia përgjegjëse nuk ka nxjerrë aktet e emërimit pas procesit të ristrukturimit, detyrim ku i përcaktuar në nenin 50 e vijues të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, pavarësisht faktit që kjo njësi nuk ka pësuar ndryshim (*nuk ka pasur shkurtrim të pozicioneve të punës dhe nuk ka ndryshime në strukturë*).

Edhe pretendimi tjetër i ngritur në observacionin , ku kërkohet rishikimi i pikave 3 dhe 4 në rubrikën “*Konkluzione*”, në të cilat bëhet fjalë për marrjen e vendimit të riemërimit, pas implementimit të ristrukturimit, për ata nëpunës që mbeten në ato funksione që kishin më parë, të cilat nuk kanë ndryshuar emërtesë apo strukturë, vlerësohet si jo bindës për të ndryshuar qëndrim, për arsyen e mëposhtme:

Këshilli i Qarkut Dibër ka kaluar një proces ristrukturimi, procedura e të cilit rregullohet nga neni 50 i ligjit 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; Vendimi nr.171, datë 26.03.2014, “*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil*”, të Këshillit të Ministrave, Kreu III “*Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit*” dhe Vendimi nr.142, datë 12.03.2014, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*” të Këshillit të Ministrave. Dispozita e mësipërme ligjore janë zbatuar në mënyrë korrekte nga ana e njësisë përgjegjëse që nga krijimi i komisionit të ristrukturimit deri në daljen e vendimit përfundimtar prej njësisë përgjegjëse, në bazë të propozimit të komisionit të ristrukturimit. Kompetencat e parashikuara në dispozitat e mësipërme janë konkretizuar me Vendimin nr. 01, dt.05.02.2015 “*Për transferimin, lirimin dhe sistemimin në listën e pritjes të nëpunësve si pasojë e ristrukturimit dhe shkurtimit*” të Komisionit të Ristrukturimit. Pra vendimet e riemërimit të nëpunësve civilë, të cilëve nuk i ka ndryshuar emërtesa e pozicionit të punës duhet të dalin në referim të Vendimit nr. 01, dt.05.02.2015 “*Për transferimin, lirimin dhe sistemimin në listën e pritjes të nëpunësve si pasojë e ristrukturimit dhe shkurtimit*”. Vendimet e riemërimit, janë nga ana formale, akte administrative që konkludojnë përmbylljen e procesit të ristrukturimit sipas parashikimeve të nenit 50 të ligjit 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; Vendimi nr.171, datë 26.03.2014, “*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil*”, të Këshillit të Ministrave, Kreu III “*Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit*” dhe Vendimi nr.142, datë 12.03.2014, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*” të Këshillit të Ministrave dhe nuk trajtohen si fillimi i marrëdhënies të punës në shërbimin civil.

**IV. Procedura ligjore e ndjekur nga njësia përgjegjëse e burimeve njerëzore në marrjen e vendimit përfundimtar të lirimit nga shërbimi civil i nëpunësve që i është shkurtuar pozicioni i punës për shkak të ristrukturimit të institucionit, komentit ligjor dhe konkluzionet për secilin rast.**

Me Vendimin nr.1, datë 05.02.2015, "Për transferimin, lirimimin dhe sistemimin në listën e pritjes të nëpunësve si pasojë e ristrukturimit dhe shkurtimit të pozicionit të punës", Njësia Përgjegjëse, bazuar në kompetencat e parashikuara në nenin 50, pika 3, e ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar; Vendimit nr.171, dt.26.03.2014, "Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimimin nga shërbimi civil", të Këshillit të Ministrave, ka vendosur për nëpunësit që do të lirohen nga shërbimi civil në pamundësi sistemimi për shkak të shkurtimit të pozicionit të punës dhe ndryshimit të kërkesave të posaçme të pozicionit të rikrijuar pas ristrukturimit. Nëpunësit të cilët janë propozuar nga Komisioni i Ristrukturimit për t'u liruar nga detyra për shkak të ristrukturimit të institucionit janë si më poshtë:

1. \*\*\*\*\* , ish nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, me detyrë specialist auditi (kategoria IV-a, fillimi i marrëdhënies së punës, akti nr.59, dt.01.10.2012). Aktin e çertifikimit të statusit nr.42, datë 10.06.2014, nëpunësi e ka në pozicionin e mësipërm. Me vendimin nr.09, datë 09.02.2015, të njësisë përgjegjëse, është vendosur lirimimi i punonjësit \*\*\*\*\* nga shërbimi civil. Në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.03, datë 30.01.2015, të Këshillit të Qarkut Dibër, ekziston vetëm një pozicion pune specialist auditi, nga dy pozicione që ishin në strukturën paraardhëse.

2. \*\*\*\*\* , ish nëpunës civil i kategorisë ekzekutive, me detyrë specialist personeli në ish Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (kategoria IV-b, fillimi i marrëdhënies së punës, akti nr.20, dt.20.04.2012).

Aktin e çertifikimit të statusit nr.49, date 10.06.2014, \*\*\*\*\* e ka në pozicionin e sipërcituar. Me vendimin nr. 10, datë 09.02.2015, të njësisë përgjegjëse, me të drejtë është vendosur lirimimi i punonjësit nga shërbimi civil, pasi në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.03, datë. 30.01.2015, të Këshillit të Qarkut Dibër, nuk ekziston as Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe as pozicioni i punonjësit.

Funksionet e drejtorisë së mësipërme, në strukturën e re i kryen sektori i menaxhimit të burimeve njerëzore, ndërsa sipas përshkrimit të punës detyrat e ish punonjësit do të kryhen nga nëpunësi \*\*\*\*\* (specialist jurist).

3. \*\*\*\*\* , ish nëpunës civile e kategorisë ekzekutive me detyrë specialiste në ish Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (kategoria IV- b, fillimi i marrëdhënies së punës, akti nr.24, dt.01.03.2011).

Aktin e çertifikimit të statusit nr. 43, datë 10.06.2014, \*\*\*\*\* e ka në pozicionin e sipërcituar. Me vendimin nr.11, datë 09.02.2015, të njësisë përgjegjëse është vendosur lirimimi i saj nga shërbimi civil. pasi në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.03, datë. 30.01.2015, të Këshillit të Qarkut Dibër, nuk ekziston as Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe as pozicioni i punonjës (është shkurtuar pozicioni i ish punonjës, nga 4 specialistë, efektivë janë 2 nëpunës civilë).

4. \*\*\*\*\*, ish nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, me detyrë specialist arkivi (*kategoria IV-b, fillimi i marrëdhënies së punës, akti nr.49, dt.31.08.2012*). Me vendimin nr.13, datë 30.01.2015, të njësisë përgjegjëse, është vendosur lirimi i punonjësit \*\*\*\*\* nga shërbimi civil për shkak të mosplotësimit të kriterëve të posaçme për pozicionin e punës (*ishite me arsim të mesëm*).

5. \*\*\*\*\*, ish nëpunës civile i kategorisë ekzekutive, me detyrë specialist për komunat në ish sektorin juridik në përbërje të Drejtorisë së Financës (*kategoria IV-b, fillimi i marrëdhënies së punës, akti nr.11, dt.03.02.2014* ). Aktin e çertifikimit të statusit nr.69, datë 10.06.2014, punonjësi e ka në pozicionin e sipërcituar, si nëpunës civil në periudhë prove. Me vendimin nr.12, datë 09.02.2015, të njësisë përgjegjëse, është vendosur lirimi i punonjësit \*\*\*\*\* nga shërbimi civil. Në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.03, datë 30.01.2015, të Këshillit të Qarkut Dibër, nuk ekziston as Drejtoria e Financës dhe as sektori juridik i përfshirë në të.. Funkzionet e drejtorisë së mësipërme, në strukturën e re i kryen sektori ekonomik me strukturë 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë, nga 6 pozicione pune në shërbimin civil që ka pasur më parë.

6. \*\*\*\*\*, ish nëpunës civil i kategorisë ekzekutive, me detyrë specialist për marrëdhëniet me institucionet në ish sektorin juridik në përbërje të Drejtorisë së Financës (*kategoria IV-b, fillimi i marrëdhënies së punës, akti nr.19, dt.02.05.2014 dhe pas përfundimit të procedurës së konkurimit, emëruar me urdhërin 110, datë 20.10.2014*). Me vendimin nr.13, datë 09.02.2015, të njësisë përgjegjëse, është vendosur lirimi i punonjësit \*\*\*\*\* nga shërbimi civil. Në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.03, datë 30.01.2015, të Këshillit të Qarkut Dibër, nuk ekziston as Drejtoria e Financës dhe as sektori juridik i përfshirë në të. Funkzionet e drejtorisë së mësipërme, në strukturën e re i kryen sektori ekonomik me strukturë 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë, nga 6 pozicione pune në shërbimin civil që ka pasur më parë.

7. \*\*\*\*\*, ish nëpunës civil i kategorisë ekzekutive, me detyrë specialist për prokurimet në ish sektorin juridik në përbërje të Drejtorisë së Financës (*kategoria IV-b, fillimi i marrëdhënies së punës, akti nr.16, dt.02.05.2014 dhe pas përfundimit të procedurës së konkurimit, emëruar me urdhërin 111, datë 20.10.2014*). Me vendimin nr.14, datë 09.02.2015, të njësisë përgjegjëse, është vendosur lirimi i punonjësit \*\*\*\*\* nga shërbimi civil. Në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.03, datë 30.01.2015, të Këshillit të Qarkut Dibër, nuk ekziston as Drejtoria e Financës dhe as sektori juridik i përfshirë në të.. Funkzionet e drejtorisë së mësipërme, në strukturën e re i kryen sektori ekonomik me strukturë 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë, nga 6 pozicione pune në shërbimin civil që ka pasur më parë.

8. \*\*\*\*\*, ish nëpunës civil i kategorisë ekzekutive, me detyrë specialist I pyjeve dhe mjedisit në ish sektorin e zhvillimit, në varësi administrative nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit (*kategoria IV-b, fillimi i marrëdhënies së punës, akti nr.53, datë 03.09.2012* ). Aktin e çertifikimit të statusit nr.40, datë 10.06.2014, nëpunësi e ka në

pozicionin e sipërcituar. Me vendimin nr.15, datë 09.02.2015, të njësisë përgjegjëse, është vendosur lirimi i punonjësit \*\*\*\*\* nga shërbimi civil. Në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.03, datë 30.01.2015, të Këshillit të Qarkut Dibër, nuk ekziston as Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit së bashku me dy sektorët që kishte në varësi administrative, ai i zhvillimit dhe i teknologjisë së informacionit. Po kështu është shkurtuar dhe numri i pozicioneve të punës që përfshihen në fushën e shërbimit civil nga 12, aktualisht janë 4 nëpunës civil të punësuar në sektorin e projekteve rajonale që ka marrë funksionet e ish Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit.

**9.** \*\*\*\*\* , ish nëpunës civil i kategorisë ekzekutive, me detyrë specialist për bujqësinë në ish sektorin e zhvillimit, në varësi administrative nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit (*kategoria IV-b, fillimi i marrëdhënies së punës, akti nr.32, datë 01.06.2010*). Aktin e çertifikimit të statusit nr.53, datë 10.06.2014, nëpunësi e ka në pozicionin e sipërcituar. Me vendimin nr.16, datë 09.02.2015, të njësisë përgjegjëse, është vendosur lirimi i punonjësit \*\*\*\*\* nga shërbimi civil. Në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.03, datë 30.01.2015, të Këshillit të Qarkut Dibër, nuk ekziston as Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit së bashku me dy sektorët që kishte në varësi administrative, ai i zhvillimit dhe i teknologjisë së informacionit. Po kështu është shkurtuar dhe numri i pozicioneve të punës që përfshihen në fushën e shërbimit civil nga 12, aktualisht janë 4 nëpunës civil të punësuar në sektorin e projekteve rajonale që ka marrë funksionet e ish Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit.

**10.** \*\*\*\*\* , ish nëpunës civil i kategorisë ekzekutive, me detyrë specialist i arsimit dhe i kulturës në ish sektorin e zhvillimit, në varësi administrative nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit (*kategoria IV-b, fillimi i marrëdhënies së punës, akti nr.38, datë 01.03.2011*). Aktin e çertifikimit të statusit nr.50, datë 10.06.2014, nëpunësi e ka në pozicionin e sipërcituar. Me vendimin nr.16, datë 09.02.2015, të njësisë përgjegjëse, është vendosur lirimi i punonjësit \*\*\*\*\* nga shërbimi civil. Në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.03, datë 30.01.2015, të Këshillit të Qarkut Dibër, nuk ekziston as Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit së bashku me dy sektorët që kishte në varësi administrative, ai i zhvillimit dhe i teknologjisë së informacionit. Po kështu është shkurtuar dhe numri i pozicioneve të punës që përfshihen në fushën e shërbimit civil nga 12, aktualisht janë 4 nëpunës civil të punësuar në sektorin e projekteve rajonale që ka marrë funksionet e ish Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit.

**11.** \*\*\*\*\* , ish nëpunëse civile e kategorisë ekzekutive, me detyrë specialiste e projekteve të biznesit në ish sektorin e projekteve në varësi administrative nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit (*kategoria IV-b, fillimi i marrëdhënies së punës, akti nr.05, datë 01.04.2013*). Aktin e çertifikimit të statusit nr.73, datë 10.06.2014, nëpunësja e ka në pozicionin e sipërcituar. Me vendimin nr.18, datë 09.02.2015, të njësisë përgjegjëse, është vendosur lirimi i punonjësës \*\*\*\*\* nga shërbimi civil. Në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.03, datë 30.01.2015, të Këshillit të Qarkut Dibër, nuk ekziston as Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit së bashku me dy sektorët që kishte në varësi administrative, ai i zhvillimit dhe i teknologjisë së informacionit. Sektori i projekteve rajonale ka organike 1 përgjegjës sektori dhe 1 specialist nga 4 specialistë që

kishte në strukturën paraardhëse (*shkurtuar 2 pozicione pune në shërbimin civil, një ndër to pozicioni i M.Rinës*).

**12.** \*\*\*\*\*, ish nëpunëse civile e kategorisë ekzekutive, me detyrë specialiste e projekteve sociale në ish sektorin e projekteve në varësi administrative nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit (*kategoria IV-b, fillimi i marrëdhënies së punës, akti nr.16, datë 19.05.2009*). Aktin e çertifikimit të statusit nr.55, datë 10.06.2014, nëpunësja e ka në pozicionin e sipërcituar. Me vendimin nr.19, datë 09.02.2015, të njësisë përgjegjëse, është vendosur lirimi i punonjësës \*\*\*\*\* nga shërbimi civil. Në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.03, datë 30.01.2015, të Këshillit të Qarkut Dibër, nuk ekziston as Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit së bashku me dy sektorët që kishte në varësi administrative, ai i zhvillimit dhe i teknologjisë së informacionit. Sektori i projekteve rajonale ka organike 1 përgjegjës sektori dhe 1 specialist nga 4 specialistë që kishte në strukturën paraardhëse (*shkurtuar 2 pozicione pune në shërbimin civil, një ndër to pozicioni i M.Rinës*).

**13.** \*\*\*\*\*, ish nëpunëse civile e kategorisë ekzekutive, me detyrë specialiste e projekteve sociale në ish sektorin e projekteve në varësi administrative nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit (*kategoria IV-b, fillimi i marrëdhënies së punës, akti nr.08, datë 02.03.2009*). Aktin e çertifikimit të statusit nr.44, datë 10.06.2014, nëpunësja e ka në pozicionin e sipërcituar. Me vendimin nr.51, datë 09.02.2015, të njësisë përgjegjëse, është vendosur lirimi i punonjësës \*\*\*\*\* nga shërbimi civil. Në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.03, datë 30.01.2015, të Këshillit të Qarkut Dibër, nuk ekziston as Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit së bashku me dy sektorët që kishte në varësi administrative, ai i zhvillimit dhe i teknologjisë së informacionit. Sektori i projekteve rajonale ka organike 1 përgjegjës sektori dhe 1 specialist nga 4 specialistë që kishte në strukturën paraardhëse (*shkurtuar 2 pozicione pune në shërbimin civil, një ndër to pozicioni i \*\*\*\*\**).

**14.** \*\*\*\*\*, ish nëpunës civil i kategorisë ekzekutive, me detyrë specialist i statistikës në ish sektorin e teknologjisë së informacionit dhe statistikës në varësi administrative nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit (*kategoria IV-b, fillimi i marrëdhënies së punës, akti nr.60, datë 01.10.2012*). Aktin e çertifikimit të statusit nr.46, datë 10.06.2014, nëpunësi e ka në pozicionin e sipërcituar. Me vendimin nr.30, datë 09.02.2015, të njësisë përgjegjëse, është vendosur lirimi i punonjësit \*\*\*\*\* nga shërbimi civil. Në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.03, datë 30.01.2015, të Këshillit të Qarkut Dibër, nuk ekziston as Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit së bashku me dy sektorët që kishte në varësi administrative, ai i zhvillimit dhe i teknologjisë së informacionit.

**15.** \*\*\*\*\*, ish nëpunëse civile e kategorisë ekzekutive, me detyrë specialiste e teknologjisë së informacionit në ish sektorin e teknologjisë së informacionit dhe statistikës në varësi administrative nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit (*kategoria IV-b, fillimi i marrëdhënies së punës, akti nr.27, datë 01.03.2011*). Aktin e çertifikimit të statusit nr.45, datë 10.06.2014, nëpunësja e ka në pozicionin e sipërcituar. Me vendimin nr.20, datë

09.02.2015, të njësisë përgjegjëse, është vendosur lirimi i punonjësës \*\*\*\*\* nga shërbimi civil. Në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.03, datë 30.01.2015, të Këshillit të Qarkut Dibër, nuk ekziston as Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit së bashku me dy sektorët që kishte në varësi administrative, ai i zhvillimit dhe i teknologjisë së informacionit.

**16.** \*\*\*\*\*, ish nëpunës civil i kategorisë ekzekutive, me detyrë specialist planifikues në ish sektorin e planifikimit urban në varësi administrative nga Drejtoria e Urbanistikës ( *fillimi i marrëdhënies së punës, akti nr.1/4, dt.04.01.2001*). Me vendimin nr.33, datë 30.01.2015, të njësisë përgjegjëse, është vendosur lirimi i punonjësit \*\*\*\*\* nga shërbimi civil për shkak të mosplotësimit të kriterëve të posaçme për pozicionin e punës (*ishte me arsim të mesëm*).

**17.** \*\*\*\*\*, ish nëpunës civil i kategorisë ekzekutive, me detyrë specialist i projekteve urbane në ish sektorin e planifikimit urban në varësi administrative nga Drejtoria e Urbanistikës ( *fillimi i marrëdhënies së punës, akti nr.57, dt.01.10.2012*). Me vendimin nr.34, datë 30.01.2015, të njësisë përgjegjëse, është vendosur lirimi i punonjësit \*\*\*\*\* nga shërbimi civil për shkak të mosplotësimit të kriterëve të posaçme për pozicionin e punës (*ishte me arsim të mesëm*).

**18.** \*\*\*\*\*, ish nëpunës civil i kategorisë ekzekutive, me detyrë specialist hidroteknik në ish sektorin e planifikimit urban në varësi administrative nga Drejtoria e Urbanistikës (*kategoria IV-a, fillimi i marrëdhënies së punës, akti nr.30, dt.01.03.2011*). Aktin e certifikimit të statusit nr.48, datë 10.06.2014, nëpunësi e ka në pozicionin e sipërcituar. Me vendimin nr.21, datë 09.02.2015, të njësisë përgjegjëse, është vendosur lirimi i punonjësit \*\*\*\*\* nga shërbimi civil. Në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.03, datë 30.01.2015, të Këshillit të Qarkut Dibër, funksionet e ish Drejtorisë së Urbanistikës i ushtron sektori i planifikimit urban me organikë, 1 përgjegjës sektori dhe 1 specialist, gjithsej 2 nëpunës civilë, nga 6 nëpunës civilë që ishin në strukturën parardhëse.

**19.** \*\*\*\*\*, ish nëpunës civil i kategorisë ekzekutive, me detyrë specialist mjedisi në ish sektorin e planifikimit urban në varësi administrative nga Drejtoria e Urbanistikës (*kategoria IV-a, fillimi i marrëdhënies së punës, akti nr.09, dt.03.02.2014*). Aktin e certifikimit të statusit nr.71, datë 10.06.2014, nëpunësi e ka në pozicionin e sipërcituar si nëpunës civil në periudhë prove. Me vendimin nr.22, datë 09.02.2015, të njësisë përgjegjëse, është vendosur lirimi i punonjësit \*\*\*\*\* nga shërbimi civil. Në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.03, datë 30.01.2015, të Këshillit të Qarkut Dibër, funksionet e ish Drejtorisë së Urbanistikës i ushtron sektori i planifikimit urban me organikë, 1 përgjegjës sektori dhe 1 specialist, gjithsej 2 nëpunës civilë, nga 6 nëpunës civilë që ishin në strukturën parardhëse.

**20.** \*\*\*\*\*, ish nëpunës civil i nivelit të ulët drejtues, me detyrë Kryeinspektor i Inspektoriatit Ndërtimor Urbanistik Vendor, në varësi administrative nga Drejtoria e Urbanistikës (*kategoria III-a, fillimi i marrëdhënies së punës, akti nr.56, dt.01.10.2014*).

Aktin e certifikimit të statusit nr.63, datë 10.06.2014, nëpunësi e ka në pozicionin e sipërcituar. Me vendimin nr.39, datë 09.02.2015, të njësisë përgjegjëse, është vendosur lirimi i punonjësit \*\*\*\*\* nga shërbimi civil. Në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.03, datë 30.01.2015, të Këshillit të Qarkut Dibër, nuk ekziston Inspektoriati Ndërtimor Urbanistik Vendor.

**21.** \*\*\*\*\*, ish nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, me detyrë inspektor i Inspektoriatit Ndërtimor Urbanistik Vendor, në varësi administrative nga Drejtoria e Urbanistikës (*kategoria IV-a, fillimi i marrëdhënies së punës, akti nr.46, dt.16.07.2008*). Aktin e certifikimit të statusit nr.64, datë 10.06.2014, nëpunësi e ka në pozicionin e sipërcituar. Me vendimin nr.39, datë 09.02.2015, të njësisë përgjegjëse, është vendosur lirimi i punonjësit \*\*\*\*\* nga shërbimi civil, sepse në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.03, datë 30.01.2015, të Këshillit të Qarkut Dibër, nuk ekziston Inspektoriati Ndërtimor Urbanistik Vendor.

**22.** \*\*\*\*\*, ish nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, me detyrë specialist për investimet në ish Drejtorinë e Shërbimeve Rajonale (*kategoria IV-a, fillimi i marrëdhënies së punës, akti nr.22, dt.02.05.2014 dhe emërimi në shërbimin civil pas përfundimit të procedurës së konkurimit me Urdhërin nr.112, datë 20.10.2014*). Me vendimin nr.23, datë 09.02.2015, të njësisë përgjegjëse, është vendosur lirimi i punonjësit \*\*\*\*\* nga shërbimi civil, sepse në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.03, datë 30.01.2015, të Këshillit të Qarkut Dibër, nuk ekziston Drejtoria e Shërbimeve Rajonale dhe funksionet e saj i kanë kaluar sektorit të shërbimeve. Për më tepër ka shkurtime të pozicioneve të punës, nga 7 nëpunës civilë në strukturën aktuale janë 2 nëpunës civil, pra janë shkurtuar 5 pozicione pune në shërbimin civil.

**23.** \*\*\*\*\*, ish nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, me detyrë specialist për infrastrukturën në ish Drejtorinë e Shërbimeve Rajonale (*kategoria IV-a, fillimi i marrëdhënies së punës, akti nr.18, dt.02.05.2014 dhe emërimi në shërbimin civil pas përfundimit të procedurës së konkurimit me Urdhërin nr.114, datë 20.10.2014*). Me vendimin nr.24, datë 09.02.2015, të njësisë përgjegjëse, është vendosur lirimi i punonjësit \*\*\*\*\* nga shërbimi civil, sepse në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.03, datë 30.01.2015, të Këshillit të Qarkut Dibër, nuk ekziston Drejtoria e Shërbimeve Rajonale dhe funksionet e saj i kanë kaluar sektorit të shërbimeve. Për më tepër ka shkurtime të pozicioneve të punës, nga 7 nëpunës civilë në strukturën aktuale janë 2 nëpunës civil, pra janë shkurtuar 5 pozicione pune në shërbimin civil.

**24.** \*\*\*\*\*, ish nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, me detyrë specialist për shërbimet sociale në ish Drejtorinë e Shërbimeve Rajonale (*kategoria IV-a, fillimi i marrëdhënies së punës, akti nr.21, dt.02.05.2014 dhe emërimi në shërbimin civil pas përfundimit të procedurës së konkurimit me Urdhërin nr.108, datë 20.10.2014*). Me vendimin nr.25, datë 09.02.2015, të njësisë përgjegjëse, është vendosur lirimi i punonjësit \*\*\*\*\* nga shërbimi civil, sepse në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.03, datë 30.01.2015, të Këshillit të Qarkut Dibër, nuk ekziston Drejtoria e Shërbimeve Rajonale dhe funksionet e saj i kanë kaluar sektorit të shërbimeve. Për më

tepër ka shkurtime të pozicioneve të punës, nga 7 nëpunës civilë në strukturën aktuale janë 2 nëpunës civil, pra janë shkurtuar 5 pozicione pune në shërbimin civil.

25. \*\*\*\*\*, ish nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, me detyrë specialist për ujësjellësin në ish Drejtorinë e Shërbimeve Rajonale (*kategoria IV-a, fillimi i marrëdhënies së punës, akti nr.26, dt.01.03.2011*). Aktin e deklarimit të statusit të punësimit nr.57, datë 10.06.2014, ish nëpunësi e ka në pozicionin e sipërcituar. Me vendimin nr.28, datë 09.02.2015, të njësisë përgjegjëse, është vendosur lirimi i punonjësit \*\*\*\*\* nga shërbimi civil, sepse në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.03, datë 30.01.2015, të Këshillit të Qarkut Dibër, nuk ekziston Drejtoria e Shërbimeve Rajonale dhe funksionet e saj i kanë kaluar sektorit të shërbimeve. Për më tepër ka shkurtime të pozicioneve të punës, nga 7 nëpunës civilë në strukturën aktuale janë 2 nëpunës civil, pra janë shkurtuar 5 pozicione pune në shërbimin civil.

26. \*\*\*\*\*, ish nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, me detyrë specialist-inspektor në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës (*kategoria IV-a, fillimi i marrëdhënies së punës, akti nr.26, dt.01.03.2011*). Aktin e deklarimit të statusit të punësimit nr.71, datë 16.12.2008, ish nëpunësi e ka në pozicionin e sipërcituar. Me vendimin nr.29, datë 09.02.2015, të njësisë përgjegjëse, është vendosur lirimi i punonjësit \*\*\*\*\* nga shërbimi civil. Në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.03, datë 30.01.2015, të Këshillit të Qarkut Dibër, Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës ekziston përsëri, por është shkurtuar 1 pozicion pune specialist, nga organike që ka pasur 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë, në strukturën aktuale ka organikë 1 përgjegjës sektori dhe 1 specialist.

**Konkluzion:** Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, konstaton se, në strukturën aktuale të miratuar me Vendimin nr.03, datë 30.01.2015 të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Dibër, pozicioni i specialistit në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës është i paplotësuar. Për rrjedhojë, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil arrin në përfundimin se një ndër dy specialistët e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Tokës duhet të emërohet në pozicionin që ka mbetur i paplotësuar në strukturën aktuale. Kompetencën ligjore për emërimin e njërit prej dy nëpunësve të cilët janë liruar në kundërshtim me nenin 50 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; Vendimin nr.171, datë 26.03.2014, “*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil*”, të Këshillit të Ministrave, Kreu III “*Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit*” dhe Vendimin nr.142, datë 12.03.2014, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*” të Këshillit të Ministrave, e ka njësia përgjegjëse.

27. \*\*\*\*\*, ish nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, me detyrë specialist-inspektor në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës (*kategoria IV-a, fillimi i marrëdhënies së punës, akti nr.10, dt.03.02.2014*). Aktin e deklarimit të statusit të punësimit nr.70, datë 16.12.2008, ish nëpunësi e ka në pozicionin e sipërcituar, nëpunës civil në periudhë prove. Me vendimin nr.30, datë 09.02.2015, të njësisë përgjegjëse, është vendosur lirimi i punonjësit \*\*\*\*\* nga shërbimi civil. Në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.03, datë 30.01.2015, të Këshillit të Qarkut Dibër, Inspektoriatin e Mbrojtjes së



Tokës ekziston përsëri, por është shkurtuar 1 pozicion pune specialist, nga organike që ka pasur 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë, në strukturën aktuale ka organikë 1 përgjegjës sektori dhe 1 specialist.

**Konkluzion:** Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, konstaton se, në strukturën aktuale të miratuar me Vendimin nr.03, datë 30.01.2015 të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Dibër, pozicioni i specialistit në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës është i paplotësuar. Për rrjedhojë, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil arrin në përfundimin se një ndër dy specialistët e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Tokës duhet të emërohet në pozicionin që ka mbetur i paplotësuar në strukturën aktuale. Kompetencën ligjore për emërimin e njërit prej dy nëpunësve të cilët janë liruar në kundërshtim me nenin 50 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Vendimin nr.171, datë 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”, të Këshillit të Ministrave, Kreu III “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit” dhe Vendimin nr.142, datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” të Këshillit të Ministrave, e ka njësia përgjegjëse.

**28.** \*\*\*\*\* , ish nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, me detyrë specialist për mjedisin në ish Drejtorinë e Shërbimeve Rajonale (*kategoria IV-a, fillimi i marrëdhënies së punës, akti nr.20, dt.02.05.2014 dhe emërimi në shërbimin civil pas përfundimit të procedurës së konkurimit me Urdhërin nr.113, datë 20.10.2014*). Me vendimin nr.26, datë 09.02.2015, të njësisë përgjegjëse, është vendosur lirimi i punonjësit \*\*\*\*\* nga shërbimi civil, sepse në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.03, datë 30.01.2015, të Këshillit të Qarkut Dibër, nuk ekziston Drejtoria e Shërbimeve Rajonale dhe funksionet e saj i kanë kaluar sektorit të shërbimeve. Për më tepër ka shkurtime të pozicioneve të punës, nga 7 nëpunës civilë në strukturën aktuale janë 2 nëpunës civil, pra janë shkurtuar 5 pozicione pune në shërbimin civil.

**29.** \*\*\*\*\* , ish nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, me detyrë specialist për emergjencat në ish Drejtorinë e Shërbimeve Rajonale (*kategoria IV-a, fillimi i marrëdhënies së punës, akti nr.15, dt.01.03.2011*). Aktin e deklarimit të statusit të punësimit nr.54, datë 10.06.2014, ish nëpunësi e ka në pozicionin e sipërcituar. Me vendimin nr.27, datë 09.02.2015, të njësisë përgjegjëse, është vendosur lirimi i punonjësit \*\*\*\*\* nga shërbimi civil, sepse në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.03, datë 30.01.2015, të Këshillit të Qarkut Dibër, nuk ekziston Drejtoria e Shërbimeve Rajonale dhe funksionet e saj i kanë kaluar sektorit të shërbimeve. Për më tepër ka shkurtime të pozicioneve të punës, nga 7 nëpunës civilë në strukturën aktuale janë 2 nëpunës civil, pra janë shkurtuar 5 pozicione pune në shërbimin civil.

**Konkluzion :** Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil konstaton se, të gjithë aktet e lirimit të nxjerra nga njësia përgjegjëse kanë dalë në përputhje me kërkesat e nenit 50 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Vendimin nr.171, datë 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil” të Këshillit të Ministrave, Kreu III “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit” dhe Vendimin nr.142, datë 12.03.2014, “Për

*përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, të Këshillit të Ministrave. Konkretisht, nëpunësve të cilëve u është shkurtuar pozicioni i punës janë njoftuar 1 muaj përpara për fillimin e kësaj procedure dhe, në përputhje me vjetërsinë në punë i kanë dhënë të drejtën e dëmshpërblimit sipas përcaktimeve të pikës 7 të nenit 50 të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; Vendimit nr.171, dt.26.03.2014, “*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil*” të Këshillit të Ministrave.

Përfundim nga e përgjithshmja, janë 2 aktet e lirit nga shërbimi civil për specialistët e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Tokës, të cilët janë liruar nga shërbimi civil, në një kohë që 1 pozicion specialist është i paplotësuar në strukturën aktuale.

### **KONKLuzion:**

Nisur nga parregullsitë e konstatuara, të cilat nuk cenojnë ligjshmërinë në tërësi të procesit, sepse mund të konsiderohen si të karakterit objektiv, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil rekomandon si më poshtë:

1. Kryetari i Këshillit të Qarkut Dibër të revokojë aktin e emërimit nr.10, datë 02.05.2013 të specialistes të kontabilitetit \*\*\*\*\* dhe njësia përgjegjëse ose të emërojë nëpunës civil nga lista e pritjes, ose të shpallë si të lirë këtë pozicion pune.
2. Detyrimin e njësisë përgjegjëse të revokojë një ndër dy aktet e lirit nga shërbimi civil, atë nr.29, datë 09.02.2009 që i përket nëpunësit civil \*\*\*\*\*, ose atë nr.30, datë 09.02.2009 që i përket nëpunësit civil \*\*\*\*\* dhe bazuar në kompetencën ligjore të parashikuar në pikën 3 të nenit 50 të ligjit nr.152/2013, *Për nëpunësin civil*, i ndryshuar, Vendimit nr.171, datë 26.03.2014, *Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil* të Këshillit të Ministrave të marrë vendimin përfundimtar të emërimit për një nga dy nëpunësit civil në pozicionin e paplotësuar të specialistit në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës.
3. Njësia përgjegjëse të marrë vendimin përfundimtar të emërimit, në mënyrë nominale, për secilin nëpunës të Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, sipas parashikimeve të nenit 50 pika 3 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe Vendimit nr.171, datë 26.03.2014, “*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil*”, të Këshillit të Ministrave (të dalë akti individual i riemërimit të çdo nëpunësi të DAMT-së dhe ky të administrohet dhe të jetë pjesë e dosjes së personelit).
4. Njësia përgjegjëse të marrë vendimin përfundimtar të riemërimit pas ristrukturimit, në mënyrë nominale, për secilin prej nëpunësve civil të mëposhtëm:  
\*\*\*\*\* me detyrë Drejtor i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, \*\*\*\*\*  
me detyrë specialist jurist në sektorin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore,  
\*\*\*\*\* me detyrë Kryeinspektore e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Tokës,

- \*\*\*\*\* me detyrë specialist arkivi në sektorin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, *(pavarësisht se nuk i ka ndryshuar emërtesa dhe pozicioni i punës)* sipas parashikimeve të nenit 50 pika 3 të ligjit nr. 152/2013 ”Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimit nr.171, datë 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”, të Këshillit të Ministrave *(të dalë akti individual i riemërimit të çdo nëpunësi dhe ky të administrohet dhe të jetë pjesë e dosjes së personelit)*.
5. Njësia përgjegjëse të marrë mendimin me shkrim të gjithë nëpunësve të emëruar pas ristrukturimit sipas përcaktimeve të pikës 20, Kreu III “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”, të Vendimit nr.171, datë 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil” dhe të administrojë atë në dosjen e personelit *(dosje individuale)*.

## **KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**